

Në mbështetje të nenit 46 paragrafi 1 pika g), nenit 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. pika a) të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Komisioni Disiplinor i FBK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore mori këtë

V E N D I M

I. Olti Lipa, trajner i SHB Pressing, për shkelje të rëndë disiplinore shqiptohet masa disiplinore: ***Ndalesë në kryerje të detyrës (trajner) për periudhë të caktuar kohore prej 6 muajve.***

II. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Komisioni Disiplinor (këtu e tutje Komisioni) nëpërmjet postës elektronike, më datën 14.04.2025, ka pranuar email nga Sekretarja e Përgjithshme, znj. Elvira Duhku, në të cilin ka gjetur të bashkëngjitur kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Olti Lipa, trajner i SHB Pressing, nën dyshimet e bazuara se ka aktivizuar tre lojtarë, të cilët kanë tejkaluar moshën e lejuar për tu paraqitur në kuadër të ndeshjes së zhvilluar ndërmjet KB Peja- SHB Pressing me datë 11.04.2025. Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, Komisioni, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 16.04.2025, në orën 16:30, në lokalet e FBK-së, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç 'rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, Komisioni, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet shërbimeve të sekretarisë të FBK-së, për t'u njohur me variantin e ngjarjes apo të problemit, Olti Lipa, trajner i SHB Pressing, t'i kërkojë që të deklarohet më shkrim. Për qëllime të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 16.04.2025, Komisioni në formë online ka diskutuar pas pranimi të deklaratës nga Olti Lipa.

Më datën 18.04.2025, Komisioni, nëpërmjet email-it, nga shërbimet e sekretarisë të FBK-së, sipas kërkesës ka pranuar Deklaratën e z. Olti Lipa, trajner i SHB Pressing.

Në Deklaratën e tij z. Lipa ka thënë (teksti pa ndërhyrje):

"Përshëndetje te nderuar shpresoj te jeni mire me shëndet dhe punët po ju shkojnë mbarë. Unë jam Olti Lipa nga Peja lojtar i SHB PRESSING u16, se pari ndjejë keqardhje të madhe për situatën e krijuar, mua si lojtar pak më i vjetër më është jep



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina

detyra për të udhëhequr një lojë të fëmijëve U12 kundër KB Peja pasi të dy trajnerët Bujar Loci dhe Vigan Radoni ishin me angazhime njëri me lojërat finale me Grapeland dhe tjetri ne grumbullime me Kombëtaren e Kosovës U14.

Unë vetëm i kam marrë lojtarët të cilët kanë qenë pak më të talentuar pa e ditë çfarë viti të lindjes kanë, pasi që ka qenë hera e parë që e kam udhëhequr ndonjëherë një lojë. Unë ju kërkoj edhe një here falje të gjithëve për situatën e krijuar dhe kjo nuk do të ndodhë më asnjëherë. Mbesë me shpresë që kjo deklaratë e imja të merret parasysht. Ju përshëndes, e gjitha të mirat”.

Komisioni Disiplinor, ka shqyrtuar me kujdes pretendimet në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, dhe i ka krahasuar ato me deklaratat dhe provat e prezantuara nga z. Olti Lipa trajner i SHB Pressing dhe me dëshmitë tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës, si dhe me dokumentet ligjore në funksion të zhvillimit të procedurës disiplinore dhe ka ardhur në përfundim se, me paraqitjen e lojtarëve në ndeshjen KB Peja-SHB Pressing, jashtë moshës së lejuar për kategorinë përkatëse, z. Olti Lipa ka kryer veprim i cili konsiderohet si shkelje e rëndë disiplinore, i cili si i tillë sanksionohet me nenet si në preambulën e këtij vendimi.

Komisioni ka marrë për bazë të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikuar të i njëjti për të bërë një veprim të tillë, mirëpo nuk ka mundur ta justifikoj faktin e shkeljes së kryer dhe sidomos ndikimi që lojtarët e aktivizuar kanë mundur të ndikojnë në epilogun final të ndeshjes.

Megjithatë, në shqiptim dhe matje të dënimit Komisioni ka marrë për bazë rrethanat ndikuese që lidhen me moshën minore të z.Olti Lipa si dhe që ishte hera e para që ai udhëheq një ndeshje.

Andaj duke u mbështetur në atë që u tha më lart, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR:

Afrim Kamishi, Anëtar

Omer Daku, Kryetar

Blerim Vuniqu, Anëtar



Prishtinë, 25.04.2025



REPUBLIKAT E KOSOVËS
MINISTRIAT E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



ProCredit Bank



TEB



ART



Kufesa



MALL



automita



RUGOVE

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina

Vendimi t'u dërgohet:

- Olti Lipa
- SHB Pressing
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së dhe
- Arkivit të FBK-së.

KËSHILLË JURIDIKE:

Konform Nenit 42 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Arbitrazhit të FBK-së. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shumën prej 300 €, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRI E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

**FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS**

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina